



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS



Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/ 65

Datë: 06.02.2023.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (c), nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (a), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008” Statutit të Komunës së Malishevës, neni 12, 19 par.19.1 shkronja (a) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 30.01.2023 merr këtë:

V E N D I M

PËR PROJEKT RREGULLOREN PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE NË
KOMUNËN E MALISHEVËS

Neni 1

Miratohet Projekt-Rregullorja për Shërbime Publike Komunale, në territorin e komunës së Malishevës.

Neni 2.

Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe sanksionet, me gjobë për personat fizik dhe personat juridik, me rastin e aktiviteteve të ndryshme në territorin e Komunës së Malishevës.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës, përmes drejtorive kompetente në kuadër të Komunës së Malishevës.

Neni 4.

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008, neni 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

1. MAPL-së
2. Arkivit të komunës së Malishevës





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE



Nr.prot:09/107-MB.

Datë:14.12.2022.

N J O F T I M

Projekt- RREGULLORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE-2022..

Ky dokument ka qenë në konsultim publik nga data 23.11.2022 deri me datën: 06 .12.2022 në faqen zyrtare në platëformën online të konsultimeve publike.

Gjatë kësaj periudhe nuk janë dorëzuar komente dhe propozime nga qytetarët në formë fizike ose në e-mail adresat e zyrtarëve përgjegjës: komuna.malisheve@rks-gov.net, kkmalisheve@gmail.com, artan.pacarizi@rks-gov.net, , blerta.d.krasniqi@rks-gov.net, fadil.f.shala@rks-gov.net.

Kërkojmë të zhvillohen procedurat për rekomandim të kësaj **Projekt-RREGULLORE PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE-2022** në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës.

Malishevë, 14.12.2022

DREJTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

RIFAT MAZREKU

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja f) dhe p) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), dispozitave të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe nenit 10 dhe 19 paragrafi 19.7 shkronja (e) të Statutit të Komunës së Malishevës, nr. 01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës, me datën _____ miraton këtë:

RREGULLORE (_____)nr/2022

PËR

SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE

Neni 1

I. Dispozitat e përgjithshme

Me këtë Rregullore përcaktohen të drejtat, detyrat dhe sanksionet kundërvajtëse me gjobë për personat fizik, personat juridik, në lëmin e shërbimeve publike në territorin e Komunës së Malishevës.

Neni 2

Shërbimet publike

1. Shërbimet publike komunale, në vështrim të kësaj Rregullore konsiderohen:

- 1.1. furnizimi me ujë;
- 1.2. përcjellja dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike;
- 1.3. rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbëruara publike;
- 1.4. pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime;
- 1.5. bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- 1.6. mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike;
- 1.7. ndriçimi publik;
- 1.8. rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive dhe
- 1.9. sinjalizimi dhe numerizimi i rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike.

2. Mirëmbajtja e përmendoreve, shtatoreve, busteve, simboleve, varrezave dhe transporti lokal rregullohen me rregullore të veçanta.

Neni 3

Objektet komunale

1. Objekte komunale -publike në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- 1.1. rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit me të gjitha pajisjet përcjellëse;
- 1.2. rrugët, trotualet dhe sheshet;
- 1.3. hapësirat për parking;
- 1.4. sipërfaqet publike të gjelbëruara;
- 1.5. terrenet sportive;
- 1.6. përmendoret shtatoret, bustet, simbolet dhe varrezat;
- 1.7. rrjeti i ndriçimit publik me stabilimentet përcjellëse;
- 1.8. linjat telefonike, elektrike dhe kabllorike;
- 1.9. njejt sanitare publike;
- 1.10. tabelat për shpallje;

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm dhe me kualitet si dhe rrjet të funksional të kanalizimit.
2. Obligimet nga paragrafi paraprakë pushojnë në këto raste:
 - 2.1. të veprimit të fuqisë madhore;
 - 2.2. të pengesave të jashtëzakonshme teknike të bëra pa fajin e ndërmarrjes;
 - 2.3. të punëve të rregullta ose të jashtëzakonshme për përmirësimin e nyjeve të ujësjellësit e të kanalizimit;
 - 2.4. të kryerjes së punëve të reja ose rikonstruktimit të pajisjeve të ujësjellësit e të rrjetit të kanalizimit.
3. Për të gjitha këto raste të furnizimit jo të rregullt me ujë, ndërmarrja të cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar, që përmes mjeteve të informimit publik, t'i njoftojë shfrytëzuesit mbi shkaqet dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes së ujit.
4. Me rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara më parë të furnizimit me ujë, shfrytëzuesit duhet të njoftohen së paku 24 orë më herët me datën, kohën dhe zgjatjen e ndërprerjes.

Neni 9

Furnizimi me ujë

1. Çdo objekt publik, kolektiv dhe individual, do të jetë i furnizuar me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit dhe patjetër ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit-ujëmatësin dhe rrjetin e veçantë të kanalizimeve.
2. Me rastin e ndërtimit të rrjetit të ri të ujësjellësit dhe të kanalizimit dhe rikonstruktimit të rrjetit ekzistues, investitori është i obliguar që, përveç linjës kryesore të ujësjellësit, t'i kryejë edhe lidhjet deri te linja e rregullacionit në bazë të planit urbanistik.
3. Këto punë duhet t'i kryejë ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Neni 10

Ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit

1. Ndërtimin e rrjetit të ri nëpër rrugë, në të cilat ekzistojnë përcjellësit kryesorë të ujësjellësit dhe të kanalizimit, me kërkesën e investuesit, kryesisht i kryen ndërmarrja për ujësjellës dhe kanalizim, ose nën mbikëqyrje të saj.
2. Ndërmarrja nga paragrafi paraprakë, obligohet që gjatë ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit t'u përmbahet dispozitave sanitare-teknike mbi vënien e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Ndërmarrja nga paragrafi 1 këtij neni, është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha llojeve të punëve rreth lidhjes me rrjetin gjegjës.

Neni 11

Instalimet e rrjeteve

1. Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit lidhen në ujësjellës dhe kanalizim, me anë të pajisjeve adekuate të rrjetit. Vënia e nyjave përcjellëse nënkuptohet bashkimi i rrjetit publik të ujësjellësit deri te ujëmatësi, respektivisht prej rrjetit rrugor deri te linja e rregullacionit.
2. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, do të mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, bashkë me nyjat përcjellëse të ujëmatësit, respektivisht deri te objekti i parë akumulues i pusëtës.
3. Ndërmarrja nga paragrafi paraprakë, është e obliguar që ta mirëmbajë në gjendje të rregullt edhe ventilin e parë të ujëmatësit.

Neni 12

1. Çdo objekt i cili kufizohet me rrugët ose sheshin ku është ngritur rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit, duhet të jetë i lidhur në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit përmes nyjave përcjellëse.

shpenzimit të ujit, për disa konsumatorë të caktuar. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja për ujë dhe kanalizim dhe drejtorinë përkatëse.

Neni 32

Pëlqimi

1. Përmes hidrantëve të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat për këtë e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, në koordinim me organin Drejtorisë përkatëse.
2. Njësia e zjarfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.
3. Të gjithë shfrytëzuesit tjerë të ndërmarrjeve apo personat fizik të cilët marrin sasi të caktuara të ujit për kryerjen e ndonjë pune ndërtimore e të ngjashme, duhet patjetër të kenë leje të posaçme nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit. Shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i hidrantëve publik, rregullohet me kontratë të posaçme, ndërmjet ndërmarrjes dhe shfrytëzuesit.

Neni 33

Mirëmbajtja

Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e detyruar që rregullisht të mirëmbajë dhe ta bëjë pastrimin e përcjellësve dhe të pusetave për kanalizimin e ujërave fekale në mënyrë që në çdo kohë t'i përgjigjet destinimit të tyre.

Neni 34

Riparimet

1. Ndërmarrja e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që pas punëve të kryera ndërtimore siç është lidhja, intervenimet në prishje dhe ndërrimit të gypave, terrenin (vendin e punimeve) duhet ta kthejë në gjendje të mëparshme.
2. Obligimi nga paragrafi i mëparshëm bie në barrë të shfrytëzuesit, respektivisht të investuesit, nëse këto punë i kryen vetë (rrëmihja dhe mbulimi i vendit ku është kryer lidhja).

Neni 35

Kryesit e punëve (personat juridikë dhe fizik), menjëherë pas kryerjes së punëve, në afatin të cilin e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënies së lejes për lidhje, janë të obliguar që materialin e tepërt ta mënjanojnë nga rrugët, trotualet, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme.

Neni 36

Mbrojtja e rrjeteve

1. Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ndalohej:
 - 1.1. hedhja e mbeturinave, hirit, çimentos, rërës e fundërrinave tjera të ngjashme në rrjetin shtëpiak të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
 - 1.2. në përcjellësit e ujit të rrugëve të derdhen lëndët e ngurta e materiali tjetër;
 - 1.3. që në ujëmbledhës të hedhen mbeturinat nga pastrimi i oborreve dhe shesheve;
 - 1.4. derdhja në kanalizim të ujit dhe lëngjeve tjera, temperatura e të cilave është më e lartë se 350C ose me përmbajtje të thartirave të dëmshme të alkaleve dhe të kripërave;

- 1.5. derdhja e ujërave fundrinore pa lejen e ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 1.6. në kanal të hedhet material ndezës i cili mund të shkaktojë zjarr;
- 1.7. parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 1.8. të bëhet çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 1.9. ndalohet ujitja e kopshteve-oborreve dhe
- 1.10. ndalohet derdhja e ujit në rrugë, trotuare me qellim freskimi

Neni 37 **Gjelbërimi publik**

1. Me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe zgjerimit e kultivimit të këtyre sipërfaqeve në territorin e qytetit, vendbanimeve dhe fshatrave, ato në mbikëqyrje dhe në mbrojtje, në mënyrën si është përcaktuar me këtë Rregullore, parashihen:
 - 1.1. sipërfaqet publike të gjelbra: rendet e drunjve, gjelbërimi i ambientit në lagjet e banimit, gjelbërimi afër rrugëve të trafikut, pyjet e të ngjashme;
 - 1.2. pjesët mbrojtëse të lagjeve në qytet dhe në para lagjet e qytetit, në vendet e banuara dhe në zonat industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit dhe të sipërfaqeve tjera ujore), përveç tokës dhe mbrojtëse pyjor, e cila është pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtje nga vërshimet;
 - 1.3. sipërfaqet e gjelbra të ndërmarrjeve, organizatave e subjekteve tjera;
 - 1.4. sipërfaqet e gjelbra me destinim të veçantë dhe të dobishëm (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore historike dhe objekteve tjera me rëndësi);
 - 1.5. sipërfaqet e gjelbra për sport dhe rekreacion (oborret e shkollave, ushtrimoret, terrenet sportive, qendrat, vendet për rekreacion e të ngjashme) dhe objekteve komunale;
 - 1.6. gjelbërimi i oborreve të shtëpive, të vendeve për vikend, hapësirave të kampeve, lokaliteteve turistike dhe shëtitoreve.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozita të veçanta.

Neni 38 **Kontrolli**

1. Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e porsandërtuara, parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të organit kompetent të Komunës.
2. Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja, bëhet me anë të projektit mbi ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve të reja në harmoni me planin rregullues urban.

Neni 39 **Planifikimet**

1. Projektet e të gjitha objekteve që do të ndërtohen në pjesën e Komunës, në vete duhet të përfshijnë edhe planet dhe skicat e tokës për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre objekteve.
2. Projektet të cilat nuk i kanë planet - skicat për gjelbërim, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lejohen.
3. Nëse lejohet ndërtimi në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përgjegjësia bie mbi organin i cili e ka lëshuar lejen ndërtimore.

Neni 40 **Harmonizimi i planeve**

Të gjitha planet - skicat e gjelbërimit duhet të jenë të harmonizuara me planin e gjelbërimit të Komunës, respektivisht me konceptet e planeve rregulluese urbane, për të cilat duhet të kujdeset projektuesi, respektivisht investuesi.

Neni 41 Punimet

1. Punët rreth gjelbërimit të tërësishëm të lokacioneve, investuesit janë të detyruar t'i kryejnë para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe të punëve të tjera nëpër objekte investive.
2. Komisioni për pranimin teknik të objekteve, është i detyruar që njëkohësisht të bëjë pranimin teknik të punëve të gjelbërimit.

Neni 42

Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën e urbanizuar ndërtimore, shfrytëzuesi do t'i gjelbërojë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 43 Marrja e pëlqimit

Para se ta bëjë gjelbërimin e sipërfaqeve të parapara me këtë rregullore, shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar që të marrin pëlqimin e organit kompetent komunal.

Neni 44 Mbrojtja e sipërfaqeve publike

1. Punët rreth gjelbërimit, si kultivimi i drunjve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqes publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra, në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja së cilës i besohen këto punë.
2. Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga paragrafi paraprak, do të rregullohen me kontratë.

Neni 45

Nëse shfrytëzuesit e tokës para lokaleve të biznesit apo banimit brenda qytetit nuk e bëjnë gjelbërimin në afatin e caktuar, organi kompetent i komunës do ta urdhërojë ndërmarrjen e cila merret me këto punë, që ta bëjnë gjelbërimin me shpenzimet e shfrytëzuesit.

Neni 46

Shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra publike jashtë destinimeve të tyre themelore, mund të bëhet në rastet kur këtë e kërkon interesi publik, me pëlqimin/lejen e organit kompetent komunal.

Neni 47 Vendosja e shportave për mbeturina

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit, është e obliguar që në parqe, sheshe dhe vende tjera, të vendos dhe të mirëmbajë numrin e nevojshëm të shportave për mbeturina të imta dhe numrin e mjaftueshëm të ulëseve për pushim.

Neni 48

- 1.5. shfrytëzimi i sipërfaqeve publike dhe të tjera të gjelbëruara jashtë destinimeve të tyre themelore ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë;
- 1.6. vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali nëpër drunj dhe në pjesët tjera, pa lejen e organit kompetent për punët komunale;
- 1.7. rrëzimi dhe zhvendosja ulëseve, rekuizitave sportive, rrethojave e të ngjashme;
- 1.8. shtrirja dhe qëndrimi nëpër sipërfaqe të gjelbëruara;
- 1.9. lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësor;
- 1.10. lëshimi i ujërave të zeza nëpër parqe dhe sipërfaqe tjera publike;
- 1.11. keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësëndeve, tundullimi i ujit dhe hedhja e fundërrinave e mbeturinave tjera);
- 1.12. gjuajtja e zogjve dhe egërsirave jashtë vendeve dhe kohës së caktuar;
- 1.13. kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbëruara pa lejen e organit kompetent për punë komunale;
- 1.14. vendosja e luna - park, cirkut dhe rekuizitave tjera, pa lejen e organeve kompetente komunale;
- 1.15. shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake;
- 1.16. ndezja e zjarreve dhe djegia e gjethëve në ambiente të hapura me qëllim ose nga pakujdesia;
- 1.17. hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera;
- 1.18. mihja, hapja e puseve, mbjellja e drunjve etj për çfarëdo destinimi, pa u pajisur me leje nga organi kompetent komunal.

2. Veprimet e ndaluara në paragrafin 1 të këtij neni, analogjikisht zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pronën private.

Neni 54 Sipërfaqet publike

1. Sipërfaqet publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen ato sipërfaqe, në të cilat është i lejuar aderimi,(qëndrimi) në numër të pakufizuar i personave, si:

- 1.1. sipërfaqet e trafikut publik (rrugët dhe sipërfaqet tjera për trafik, trotualet, rrugicat dhe sipërfaqet tjera publike);
- 1.2. stacionet e autobusëve, vendqëndrimet, dhe hapësirat për parkim;
- 1.3. sipërfaqet publike dhe të gjelbra, (parqet, sheshet e vogla, drurët, sipërfaqet me bari, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion);
- 1.4. terrenet argëtuese dhe sportive (stadiumet, fushat e sportit, çerdhet etj);
- 1.5. sipërfaqet me ujë (brigjet afër lumit, pishinat) etj;
- 1.6. sipërfaqet e hapura ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe tokat e pa ndërtuara (trojet, vendet për shkarkim dhe oborret, fasadat, kulmet e ndërtesave të banimit);
- 1.7. sallat e kinemave, teatrove dhe të tjera, të cilat shërbejnë për tubime publike të qytetarëve;
- 1.8. varrezat dhe hyrjet në varreza.

Neni 55 Rrugët dhe trotualet

Rrugët janë sipërfaqe të tëra publike, të ndonjë drejtimi të përcaktuar për komunikacion.

Neni 56 Mirëmbajtja e rrugëve

1. Rrugët mbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen në bazë të destinimit.

2. Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është e obliguar që të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut dhe trotuare, t'i evitohet si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

Neni 57

Kufizimi i lëvizjeve të automjeteve

1. Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit, ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera të cilat mund të dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë, llojet e ndryshme të makinave ndërtimore dhe mjetet tjera të ngjashme.
2. Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçanta. Njëherësh, ndalohet qarkullimi i automjeteve me peshë të rëndë mbi peshën e lejuar në ato rrugë.

Neni 58

Trotuaret

1. Trotuaret janë sipërfaqe publike të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.
2. Sipërfaqet e tjera publike si: sheshet, sheshet e vogla, parqet dhe të ngjashme, shfrytëzohen në bazë të destinimit të tyre.

Neni 59

Ndalimi i shitjeve në trotuare dhe sheshe

Në sipërfaqet e trotuareve dhe të shesheve të vogla publike, nuk lejohet shitja dhe vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie në mënyrë të pa autorizuar.

Neni 60

Leja për ngarkim dhe shkarkim të mallit

1. Shkarkimi i mallit nëpër trotuare, bëhet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet nëpër oborret e ndërtesave, respektivisht të hapësirave punuese.
2. Njëkohësisht malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, e më së voni në afat prej një ore, pas shkarkimit të mallit.
3. Trotuaret dhe sheshet e vogla, mund të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialit për ngrohje vetëm me lejen paraprake të organit kompetente komunal për rrugë.

Neni 61

Afatet për shfrytëzim të hapësirave publike

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, janë të obliguar që trotuaret, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike t'i shfrytëzojnë në mënyrë si është rregulluar me këtë rregullore.
2. Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që ato t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e veta.
3. Vendosja e objekteve të përkohshme lëvizëse në hapësirat publike, mund të bëhet nga 01 maji deri më 30 shtator të vitit, me leje nga organi kompetent komunal.
4. Ndalohet hedhja e dheut, rërës, gurëve dhe materialit tjetër nëpër trotuare, sheshe të vogla, rrugë dhe sipërfaqe tjera të lira publike.

Neni 62

Leja për punime

1. Për ndërtimin e objekteve komunale, të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe telefonit e të ngjashme, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve dhe trotuareve.

Mbishkrimet e firmave ndriçuese

Mbishkrimi i firmës duhet të jetë i shkruar dhe i lexueshëm. Mbishkrimet e firmave ndriçuese ose jo ndriçuese dhe reklamat, mund të vendosen vetëm në bazë të lejes së dhënë nga ana e Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 69

Afatet e harmonizimit

Mbishkrimet e firmave ndriçuese dhe reklamat, duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj rregulloreje në afat prej 6 muajsh pas miratimit të saj.

Neni 70

Mirëmbajtja e reklamave

1. Pronarët e firmave me mbishkrime dhe reklama ndriçuese, janë të obliguar që t'i mbajnë ato në gjendje të rregullt.
2. Mbishkrimet e firmave ndriçuese mund të jenë aktive gjatë natës, prej momentit të ndezjes deri në momentin e fikjes së dritave të ndriçimit publik.

Neni 71

Vendosja e mbishkrimeve në vend punishte

Në punishtet e objekteve në ndërtim e sipër të hapësirave punuese dhe në objektin i cili renovohet ose adaptohet si punues, duhet të vendosen mbishkrimet e firmave ndriçuese sipas dokumentacionit teknik të lejuar.

Neni 72

1. Pronarët, gjegjësisht shfrytëzuesit e hapësirave punuese janë të detyruar që mbishkrimet e firmave ndriçuese t'i mbajnë në gjendje të rregullt.
2. Në rast transferimi ose ndalimi të punës, pronarët e hapësirave punuese janë të obliguar që mbishkrimet e firmës t'i largojnë.
3. Kontrollin inspektues e bënë Drejtoria përkatëse.

Neni 73

Kriteret e reklamave

1. Tabelat, mbishkrimet e firmave, reklamat dhe të ngjashme mund të ndërtohen nga materiali që garanton sigurinë e ndriçimit.
2. Format dhe madhësia e tyre duhet të jenë në pajtim me formën dhe madhësinë e fasadës dhe të hyrjes në banesë, lokale etj.
3. Ndalohet vënia e firmave varëse, jo stabile. Firmat ekzistuese varëse patjetër duhet të harmonizohen ose mënjahohen në afat prej 60 ditësh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
4. Kontrollin inspektues e bënë Drejtoria përkatëse.

Neni 74

Kontrolli institucional

1. Nëse organi i administratës komunale, kompetent për punët e inspeksionit, vërteton se mbishkrimi i firmës nuk është vendosur ose nuk është në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, do të marrë

vendim me të cilën do të obligohet subjekti afarist që mbishkrimin e firmës ta vendos në atë mënyrë si është e paraparë me rregullore.

2. Nëse shfrytëzuesi nuk vepron sipas Vendimit, vendosja e mbishkrimeve të firmave dhe largimin e mungesave të vërtetuara, do ta bëjë organi kompetent dhe shpenzimet për këtë do t'i bartë subjekti afarist.

Neni 75

Ndërtesat dhe pamja e jashtme e tyre

Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, janë të obliguar që personalisht ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës, të ndërmarrin masa gjegjëse t'ihur me pastrimin dhe mënjanimin e çfarëdo dëmtimi në linjën e ujësjiellësi, kanalizimit dhe ndriçimit në hapësirat e përbashkëta në ndërtesë.

Neni 76

Eliminimi i prishjeve

Nëse, në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundrinore, në lokalet e përbashkëta e të ngjashme, shfrytëzuesit-pronarët e lokaleve apo ndërtesave janë të obliguar, që me shpenzimet e veta t'i eliminojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit dhe ujësjiellësit.

Neni 77

Mirëmbajtja e jashtme e objekteve

1. Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj. pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), patjetër duhet të mirëmbahen në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ndërsa kushtet do t'i përcaktojë Drejtoria përkatëse.
2. Pronarët e ndërtesave dhe shfrytëzuesit janë të obliguar që fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, tarracat, ulluqet, tabelat dhe numrat e banesave e të ngjashme) të mirëmbahen, ngjyrosen, emalohen dhe të përgatiten, ashtu që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen estetike.
3. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit nga paragrafi paraprakë, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

Neni 78

Kujdesi ndaj objekteve dhe hapësirave për rreth

1. Oborret e ndërtesave dhe të lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.
2. Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit, nga paragrafi paraprakë, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave, në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

Neni 79

Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve dhe hapësirave për rreth

Pronarët e ndërtesave, respektivisht shfrytëzuesit e sipërfaqeve jo të ndërtuara, si dhe qiraxhinjtë e hapësirave afariste, janë të obliguar që t'i pastrojnë ndërtesat dhe sipërfaqet rreth ndërtesave, respektivisht të sipërfaqeve jo të ndërtuara të cilat i shfrytëzojnë ata.

Neni 80
Veprimet e ndaluara

1. Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkallë, ashensor e të ngjashme.
2. Ndalohet lëshimi i ujit dhe të ngjashme për larjen e ballkoneve me qëllim të pengimit të fqinjëve apo të tjerëve.
3. Ndalohet lrimi i tymit, çagjës, avullit, kundërmimit të rendë, gazrave toksike etj, nga ndërtesat, lokalet punuese, tyntarët, gjeneratorët etj, në afërsi të ndërtesave banesore dhe afariste shumëkatëshe, veçanërisht në afërsi të, ballkoneve, fasadave, dritareve, tarracave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë.
4. Ndalohet kryerja e punimeve pas orës 19 deri në 8 të mëngjesit, si dhe në ditët e vikendit dhe në ditë të festave.

Neni 81
Marrja e masave

1. Drejtoria përkatëse, me Vendim mund t'i urdhërojë personat përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsisë së pjesëve të ndërtesave, që t'i eliminojnë mungesat dhe pengesat menjëherë apo në një afat të caktuar.
2. Nëse obliguesi nuk vepron sipas Vendimit, ndaj tij do të merren masa sanksionuese sipas kësaj rregullore.

Neni 82
Rreziku i mundshëm

1. Ndërtesat dhe objektet e tjera të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e vetë dhe japin një pamje jo të mirë, për arsye se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinjë, duhet të rrënohen ose të mënjanohen.
2. Vendimin për rrënimin, respektivisht mënjanimin e merr Inspektori komunal për punët e ndërtimit.
3. Nëse pronari, respektivisht organi qeverisës ose personi tjetër i autorizuar, nuk e rrënon ndërtesën, respektivisht objektin tjetër në afatin e caktuar me vendim, procedurën e rrënitimit do ta bëjë Drejtoria e inspektoriatit dhe shpenzimet për këtë ia faturon obliguesit sipas vendimit.

Neni 83
Vitrinat

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të saponduara afariste ose të ndërtesave banesore me hapësirat afariste, të cilat janë paraparë për shfrytëzim për nevojat vetjake ose për dhënien e tyre me qira, janë të obliguar që vitrinat, para fillimit të përdorimit, të bëhen ashtu siç parashihet me projektin e ndërtesës.

Neni 84
Rregullimi i vitrinave

1. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste në qytet dhe në para lagjet e qytetit, janë të obliguar që vitrinat t'i rregullojnë në mënyrë estetike dhe profesionale.
2. ërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .mimet e shkruara me material të njëjtë në të gjithë artikujt.
3. Nëpër vitrinat mund të vendosen reklamat e prodhimeve dhe shërbimet e shfrytëzuesve ose të ndërmarrjeve me të cilët shfrytëzuesi është në lidhje afariste.

4. Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste dhe pronarët e tyre janë të obliguar që të vendosin orarin e punës.
5. Mbishkrimi vendoset në derën hyrëse të hapësirës afariste, shitores-lokalit, në pjesën e brendshme.

Neni 85 **Mirëmbajtja e vitrinave**

1. Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të detyruar që vitrinat t'i mbajnë pastër dhe në gjendje të rregullt.
2. Në rast të zhvillimit të punëve në adaptimin, rikonstruktimin, regjistrimin e të ngjashme, vitrinat duhet të jenë të mbuluara nga shikimi i kalimtarëve dhe atë në mënyrën më të përshtatshme.

Neni 86 **Përshtatja e vitrinave të vjetruara**

1. Pronarët, respektivisht, shfrytëzuesit e ndërtesave afariste dhe të hapësirave afariste në qytet dhe në para lagjet e qytetit janë të obliguar që t'i përshtatin dhe rregullojnë vitrinat e vjetruara të cilat e shëmtojnë pamjen e ndërtesës.
2. Inspektoriati komunal, vërteton vjetërsinë e vitrinës dhe përcakton mënyrën e përshtatjes të hapësirës afariste nga paragrafi paraprakë, respektivisht e obligon shfrytëzuesin e hapësirës në lidhje me adaptimin e vitrinës.
3. Lejen për përshtatjen e vitrinës e lëshon Drejtoria përkatëse.
4. Vitrinat, skarat etj. të nxjerra jashtë murit të lokalit dhe në trotuar, të cilat i pengojnë kalimtarët, duhet të tërhiqen në afat prej 1 muaji, nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje. Pas kalimit të këtij afati, inspektori jep urdhër me shkrim për largim. Nëse prapë nuk bëhet largimi, atëherë nxjerr vendim për mbylljen e lokalit dhe, me shpenzime të pronarit, angazhon ndërmarrjen përkatëse për largimin e pengesës në trotuar - rrugë.

Neni 87 **Rrethojat**

Të gjitha rrethojat në sipërfaqe publike pa marrë parasysh pronësinë, mund të ndërtohen vetëm në bazë të pëlqimit për atë lokacion të Drejtorisë përkatëse.

Neni 88 **Mënjanimi i rrethojave të vjetra**

1. Pronarët e rrethojave të vjetra, janë të detyruar që në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, t'i mënjanojnë ato dhe në vend të tyre të vendosin rrethojat e tipit të caktuar, sipas pëlqimit të Drejtorisë përkatëse.
2. Nëse ndërtimi i paraparë i rrethojës së tipizuar, kërkon mjete më të mëdha materiale, organi i administratës kompetente për urbanizëm, mundet përkohësisht të lejojë që në vend të rrethojës së tipizuar të vihen rrethojat prej druri të gjelbër, por që ato të mirëmbahen deri në vendosjen e tipit gjegjës të rrethojës.
3. Të gjitha rrethojat duke i përfshirë edhe rrethojat e gjelbra, duhet të mirëmbahen në gjendjen e cila nuk e prishë pamjen e përgjithshme të asaj pjese të qytetit dhe vendbanimeve tjera.

Neni 89 **Mirëmbajtja e rrethojave**

Rrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen ashtu që mos të kalojnë vijën e rregulluar dhe të mos pengojnë trafikun publik. Deri te momenti i formimit përfundimtar të rrethojës së gjelbër mund të shfrytëzohet si mbrojtëse rrethoja ekzistuese.

Neni 90

Panot dhe tabelat e shpalljeve

1. Të gjitha llojet e shpalljeve, lajmërimeve, pllakateve, monitorëve reklamues elektronik, dhe reklamave të të gjitha llojeve, mundet të vendosen vetëm në vendet e caktuara (panotë).
2. Drejtoritë përkatëse do të caktojnë numrin e caktuar të vendeve për panotë dhe tabelat e shpalljeve, me kërkesën e personave juridik - fizik.
3. Për mirëmbajtjen e panove dhe tabelave të shpalljeve do të kujdesen pronarët e tyre.
4. Për shpalljet më të vogla dhe lajmërimet për anëtarë të organizatave të ndryshme politike, kulturore dhe organizatave sportive, mund të vendosen vitrinat e vogla ose tabelat e shpalljeve në vendet e përshtatshme në afërsi të hapësirave vepruese ose afariste të atyre organizatave.
5. Vitrinat qoftë edhe vitrinat e vogla nuk mund të vendosen nëpër fasada të hapësirave afariste, nëpër shtylla, ndërtesa banesore, si dhe vende tjera publike.
6. Ndalohet:
 - 6.1. publikimi i të gjitha llojeve të shpalljeve, pllakatave, e të ngjashme, si dhe vendosja nëpër drunj dekorativ, rrethoja të objekteve, mure dhe fasada, shtylla elektrike, shtëpiza të transformatorëve, orman elektrik dhe pajisje të internetit, në shenjat e komunikacionit e të ngjashme.
 - 6.2. për vendosjen e panove dhe të reklamave nga ana e organizatave, subjekteve politike , subjekteve afariste dhe të qytetarëve nevojitet leja e organeve kompetente të administratës.
 - 6.3. për vendosjen e përkohshme të panove reklamuese dhe të tabelave të shpalljeve në vendet publike krahas kërkesës duhet t'i bashkëngjitet edhe skica ose projekti me përshkrimet teknike, i cili përmban shënimet mbi madhësinë dhe vendet ku do të vendoset dhe mbi periudhën kohore të vendosjes.

Neni 91

Gropat dhe pusetat në rrugë

1. Për sigurinë e kalimtarëve dhe lëvizjes në trafik:
 - 1.1. të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme duhet të jenë të mbyllura,
 - 1.2. pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe telefonike dhe të ngjashme gjithnjë duhet të ndërtohen dhe të mirëmbahen në gjendje të rregullt.
2. Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga paragrafi paraprake pika 1.1 janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilëve u shërbejnë, ndërsa për gropat nga pika 1.2 e këtij neni, janë të detyruara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimtari.

Neni 92

Mirëmbajtja e gropave dhe pusetave

1. Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira me këtë Rregullore, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt.
2. Gjatë kohës së përdorimit, gropat duhet patjetër të rrethohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe sipas nevojës të mbyllen mirë që të mos e pengojnë sigurimin e kalimtarëve ose trafikut.

Neni 93
Terrenet sportive

Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe publike të lira ku mbahen manifestimet sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.

Neni 94
Leja për terrenet sportive

Terrenet sportive dhe objektet sportive, nuk mund të shfrytëzohen pa lejen paraprake të titullarit.

Neni 95
Ndalesat në terret sportive

1. Ndalohet:

- 1.1. Kapërcimi i rrethojave të terreneve sportive dhe të qendrës sportive rekreative dhe hyrja në terren.
- 1.2. Hipja ose mbështetja në rrethojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative.
- 1.3. Kullotja e bagëtisë në terrenet sportive dhe terrenet tjera sportive rekreative.
- 1.4. Të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive dhe qendrat sportive e rekreative.

Neni 96
Shfrytësimi dhe mirëmbajtja e terreneve sportive

1. Terrenet për sport dhe argëtim (stadiumi, qendra sportive-rekreative, fushat e sportit dhe hapësirat e objektet e ngjashme) duhet të mirëmbahen dhe pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridik dhe individët të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.
2. Në hapësirat dhe objektet nga paragrafi paraprakë, duhet që në vend të dukshëm të vendosen në formë të shkruar udhëzimet higjienike dhe teknike mbi punë në këto hapësira dhe terrene.
3. Vizitorët janë të obliguar që t'u përmbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga paragrafi paraprak.

Neni 97
Shënimi i rrugëve dhe i objekteve

1. Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuar në këndet e tyre, tabelat me emërtimin e rrugëve ndërsa, ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre.
2. Shënimet me emërtimin e rrugëve, shesheve dhe hapësirave tjera publike, si dhe shënimet e ndërtesave, shtëpive dhe të trojeve bëhen nga ana e Drejtorisë përkatëse ose organi tjetër i autorizuar.
3. Shpenzimet sipas alinesë 1 dhe 2 të këtij neni bien në barrë të buxhetit të Komunës.
4. Për të gjitha çështjet tjera të cilat lidhen me emërtimet e rrugëve, shtëpive, ndërtesave dhe banesave zbatohen dispozitat e Ligjit për sistemimin e adresave.

Neni 98
Evidenca

1. Ndalohehet çdo gropim dhe çdo dëmtim i sipërfaqeve publike, me përjashtim për rastet e parapara me këtë rregullore.
2. Qytetarët dhe personat civil – juridik, nuk mund të bëjnë gropim të sipërfaqeve publike.
3. Sipërfaqet mund të gropohen, në bazë të lejes së organit kompetent komunal, me rastin e vendosjes së rrjetit të ri të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telefonik, elektrik të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera në rrjetë si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejme pajisjet komunale).

Neni 105

Leja e organit komunal

1. Sipërfaqet publike, me lejen e organit kompetent komunal, mund të bëjnë edhe mihjen për vendosjen e objekteve të përhershme ose të përkohshme, siç janë: shtyllat, panot, reklamat, ormanët për vendosjen e pajisjeve të internetit, telefonit, elektrikut, tabelat e shpalljeve e të ngjashme.
2. Objektet nga paragrafi paraprak, mund të mbesin edhe pas skadimit të afatit për të cilin janë vendosur, nëse shërbejnë për zbulimin e qytetit dhe nëse për to merret leja nga organi kompetent komunal.

Neni 106

Riparimi i sipërfaqeve të grupuara

Sipërfaqet e grupuara publike duhet pas punimeve të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Neni 107

Riparimi i dëmeve

1. Riparimi i prishjeve në pajisjet komunale dhe gropimi i sipërfaqeve publike, mund të bëhet nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje dhe atë vetëm në raste kur kanë ngjarë prishjet dhe duhet urgjentisht të riparohen.
2. Në këtë rast, ndërmarrja e cila e ka bërë gropimin është e obliguar që menjëherë ose më së largu ditën e parë të punës ta njoftojë organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkojë lejen për gropim.
3. Nëse organi kompetent vlerëson se riparim i prishjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bartë të gjitha pasojat.

Neni 108

Gropimi në sipërfaqe publike

Gropimin në sipërfaqet publike, në perimetër prej 1m për vënien e objekteve, mund ta bëjë edhe organizata e cila i vendos ato objekte, ndërsa meremetimin do ta kryejë vetë ose me anë të ndërmarrjes për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Neni 109

Kërkesa për leje

1. Kërkesa për marrjen e lejes për gropimin e sipërfaqeve publike, duhet t'i përmbajë shënimet mbi llojin dhe sipërfaqen e bazës (shtresës) e cila duhet të rrëmihet, qëllimin e gropimit dhe vendin e saktë në të cilën do të bëhet gropimi, koha, fillimi dhe përfundimi i punëve etj.
2. Bashkë me kërkesën duhet të bashkëngjitet edhe situata (skica), kopje e planit dhe çertifikat e pronës e terrenit në shkallën 1:500 me terrenin e vizatuar dhe sipërfaqen për gropim, si dhe me pozitën e pajisjeve komunale në krahasim me pikat markante (të poshtme), si dhe thellësinë e gropimit.

Neni 110
Dhënja e lejes

1. Lejen për gropimin në sipërfaqe publike e jep organi kompetent i Komunes.
2. Organi nga paragrafi paraprak nuk mund ta japë lejen për gropim të sipërfaqes publike nëse konsideron që mund të shkaktohen dëme personave të tretë.
3. Në vendimin për lejimin e gropimit pa tjetër duhet të shënohet koha e fillimit të gropimit dhe e përfundimit të punëve në meremetimin e sipërfaqeve të grupuara.
4. Nëse punët për shkak të gropimit të sipërfaqes publike, nuk mund të kryhen në afatin e caktuar, investuesi është i obliguar që të kërkojë vazhdimin nga organi kompetent.

Neni 111
Sigurimi i vendpunimit

1. Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike vendi ndërtimor duhet patjetër të sigurohet në mënyrë të theksuar me shenja, rrethojë dhe masat tjera mbrojtëse në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.
2. Kryesi i punëve është i obliguar veçanërisht:
 - 2.1. që gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë;
 - 2.2. që vendi ndërtimor gjatë natës të jenë i ndriçuar;
 - 2.3. që vendin ndërtimor ta rregullojë ashtu që të mundësohet qarkullimi pa pengesë i automjeteve dhe i këmbësorëve,
 - 2.4. të shënohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve;
 - 2.5. punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve.
3. pas kryerjes së punëve, vendi në të cilin është punuar, duhet të kthehet në gjendje të rregullt paraprake dhe të largohen të gjitha materialet nga vendi ndërtimor.
4. rruga për trafik, në raste të veçanta mund të groposet në tërë gjatësinë e saj nëse nuk mund të kryhen punët në mënyrë tjetër dhe atë natën në kohë prej 22:00 deri në ora 4:00 të ditës së ardhshme.

Neni 112
Kthimi në gjendjen e mëparshme

1. Baza e grupuar (sipërfaqja) duhet të kthehet në gjendje të mëparshme, sipas afatit i cili është caktuar me vendim të lejes për gropim.
2. Sipërfaqja e ndërtuar publike nuk guxon të shfrytëzohet pa lejen e organit kompetent.

Neni 113
Sigurimi i kalimit mbi pjesën e grupuar

Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse të sigurojë kalimin mbi pjesën e gruposur të rrugës.

Neni 114
Qasja në ndërtesa

Kryesi i punëve është i obliguar që të sigurojë qasje pa pengesë në ndërtesat afariste dhe në lokale si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

Neni 115

Njoftimet për punime

1. Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimit të rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet të cilat kujdesen për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe organizatat të cilat në ato rrugë posedojnë objekte duhet të jenë të njoftuara së paku 1 muaj para fillimit të ndërtimit, rikonstruktimit që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta në këto pajisje.
2. Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat e alinesë paraprake, janë të obliguara që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet që të njëjtit ta njoftojnë investitorin i cili punon ose rikonstruktin rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.
3. Rrugët e projektuara dhe të rikonstruktuar nuk mund të groposen para 3 vjetëve nga mbarimi i ndërtimit ose rikonstruktimit, përveç në raste të parapara me këtë rregullore.

Neni 116

Zbatimi i rregullave

1. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike ta deponojë depozitën bankare në pajtim me rregullat e prokurimit) për evitimin e lëshimeve eventuale dhe meremetimin e sipërfaqeve publike.
2. Investuesi është i obliguar që para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike të sigurojë nga kryesi i punës garancionin për cilësinë e punëve të kryera.

Neni 117

Bartja e shpenzimeve

1. Nëse në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e grupuara paraqiten dëmtime, meremetimin e bartë investitori me shpenzimet e veta.
2. Nëse investitori nuk i kryen meremetimet në bazë të alinesë të theksuar më lartë, të njëjtat i kryen organi i administratës që ka lëshuar lejen, ndërsa të njëjtat shpenzime i ngarkohen investitorit.

Neni 118

Pastrimi i qytetit

Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet dhe në para lagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta, duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 119

Kujdesi në mirëmbajtje

Në mbajtjen e pastërtisë janë të detyruar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet dhe , organizatat tjera.

Neni 120

Përfshirja e objekteve në mirëmbajtje

1. Lidhur me mbajtjen e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj rregulloreje, përfshihen këto objekte:

- 1.1. rrugët, trotualet dhe sheshet;

- 1.2. parqet;
- 1.3. shëtitoret, terrenet sportive dhe argëtuese;
- 1.4. stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndërrurbane;
- 1.5. ambulancat, spitalet dhe çerdhet e fëmijëve;
- 1.6. stacionet e karburantit;
- 1.7. varrezat, tregjet, shtrati i lumit dhe
- 1.8. hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe toka ndërtimore e pa ndërtuar (trojet e zbrazëta);
- 1.9. hapsira tek lapidarët.

Neni 121 **Mirëmbajtja e pastërtisë**

1. Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve si dhe objektet hoteliere, auto kampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjëse ndërmarrjet subjektet të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.
2. Shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i kësaj rregulloreje janë të obliguar që në peronet, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.
3. Nyejt sanitare publik, duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të pajisura me mjete të nevojshme si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse.
4. Nyejt sanitare publik pa tjetër duhet të jenë të hapura çdo ditë të pastrohen 24h / 7d.

Neni 122

1. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike janë të obliguar që të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve.
2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'ia besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë ne pajtim me procedurat e prokurimit.

Neni 123 **Dëshmitë mbi taksën e paguar**

1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike janë të obliguar që ato t'i mbajnë në gjendje të pastër.
2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore, të hapësirave afariste dhe trojeve të zbrazëta, janë të detyruar që t'i pastrojnë trotuarët dhe sipërfaqet e tyre rreth ndërtesave para trojeve.
3. Organi i administratës kompetent për punë komunale para dhënies së lejes për shfrytëzimin e sipërfaqeve të lira publike nga subjekte të ndryshme do të sigurojë më parë dëshminë mbi taksën e paguar dhe obligimet tjera që kërkohen sipas ligjit e akteve nënligjore në fuqi.

Neni 124 **Mirëmbajtja e ndërtesave**

Të gjitha oborret dhe korridoret e ndërtesave banesore duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e oborreve dhe korridoreve të ndërtesave banesore, kujdesen pronarët respektivisht shfrytëzuesit e atyre oborreve, korridoreve dhe bodrumeve.

Neni 125
Mirëmbajtja e xhamave të vitrinave

Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që ato t'i mbajnë të pastra. Xhamat nëpër dritare dhe vitrina duhet të jenë gjithmonë të pastër dhe në gjendje të rregullt.

Neni 126
Mirëmbajtja e ambientit të fshatit

1. Të gjithë banorët në vendet e banuara me karakter fshati apo vendbanimi, janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në vendet publike dhe sipërfaqet tjera.
2. Qytetarët e vendbânimeve të karakterit të fshatit janë të obliguar t'i pastrojnë trotuaret respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të veta, oborret dhe sipërfaqet tjera përpara dhe rreth shtëpisë.
3. Ndalohet:
 - 3.1. hedhja e mbeturinave dhe materialit tjetër fundrrinor në shtratin e lumenjve, liqeve , përrenjve, në rrugë dhe në sipërfaqe tjera publike dhe kudo tjetër jashtë deponisë së qytetit;
 - 3.2. hedhja e plehut të kafshëve në sipërfaqet jashtë oborreve të tyre;
 - 3.3. kanalet përcjellëse të ujit fundrrinor dhe të fekaleve të mos kalojnë nëpër rrugë, në sipërfaqe të lira publike dhe në oborret e huaja;
 - 3.4. të mbyllen lëshesat, kanalet përcjellëse nëpër rrugët e rendit të IV dhe dëmtimet e ndryshme të këtyre pajisjeve.

Neni 127
Pastrimi i rrugëve

1. Pastrimi i rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës dhe në kohën e cila e siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe që në masën më të vogël pengon qarkullimin e kalimtarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.
2. Ndalohet pastrimi i rrugëve në kohën prej orës 7:00 deri në ora 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 128
Orari për pastrimin e rrugëve

Larja e rrugëve mund të bëhet prej orës 23:00 deri në ora 7:00 të ditës vijuese.

Neni 129
Pastrimi i rrotave nga balta

1. Të gjitha automjetet motorike dhe tërheqëse, para hyrjes në sipërfaqet publike të trafikut publik duhet patjetër të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.
2. Nga balta dhe papastërtia, patjetër duhet pastrohen edhe të gjitha mjetet bartëse para daljes në sipërfaqe publike, në trafikun publik nga shkarkimet, nga objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të bartën në sipërfaqe publike.

Neni 130
Qëndrimi i mjeteve për pastrim

1. Mjetet (qerret) tërheqëse mund të qëndrojnë, vetëm në vendin e caktuar për ato qëllime nga ndërmarrja publike që kujdeset për pastërtinë e qytetit në bashkëpunim me organet komunale.

2. Për mbajtjen e pastërtisë, në vendet sipas alinesë paraprake pronarët e mjeteve tërheqëse ia paguajnë kompensimin ndërmarrjes e cila kujdeset për mbajtjen e pastërtisë në këto vende. Ndalja dhe parkimi në trotuar, sheshet e vogla dhe rrugë i qerreve tërheqëse ndalohet rreptësishtë.

Neni 131

Vendosja e shportave dhe kontejnerëve

1. Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendosen shportat për mbeturina dhe kontejnerët për mbeturina, në numër të mjaftueshëm dhe ato i sigurojnë shfrytëzuesit.
2. Për vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave dhe kontejnerëve, kujdeset ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjienës publike.
3. Mënyrën vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe tjera publike, e cakton organi përkatës nga Drejtoria përkatëse, në bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

Neni 132

Bartja e mbeturinave

1. Bartja e mbeturinave bëhet ditën dhe natën. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten duhet patjetër të jenë të mbyllura ose të mbuluara, ashtu që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit në deponinë e caktuar.
2. Orarin për bartjen e mbeturinave e cakton Drejtoria përkatëse.

Neni 133

Mjetet speciale për bartje

1. Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat banesore e afariste bëhet me anë të enëve speciale.
2. Vendi dhe mënyra e vendosjes së enëve speciale caktohet nga ana e Drejtorisë përkatëse, në bashkëpunim me ndërmarrjen kontraktuese për bartjen e mbeturinave.

Neni 134

Numri përkatës i mjeteve për pastrim

1. Ndërmarrja dhe qytetarët janë të obliguar që me shpenzimet e veta të sigurojnë dhe të kenë numër përkatës të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësira e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira.
2. Sigurimin e enëve-mjeteve speciale nga kjo rregullore, obliguesit janë të detyruar që ta bëjnë në afat prej 1 muaji nga dita e hyrjes në fuqi të saj.

Neni 135

Transportimi në deponinë e autorizuar

1. Mbeturinat dhe fundërrinat do të transportohen në deponinë e autorizuar.
2. Vendi i mbeturinave duhet t'i plotësojë standardet sipas ligjit.

Neni 136

Ndërmarrja e autorizuar

1. Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët) e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët.

2. Ndërmarrjes kontraktuese së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e higjienës së qytetit, është e obliguar që t'i përmbahet plan programit të miratuar për pastrimin e qytetit sipas kontratës së punës.
3. Për çdo ndryshim në lidhje me planin dhe programin e pastrimit, ndërmarrja është e obliguar që t'i lajmërojë me kohë, në lidhje me ndryshimet, organet gjegjëse mbikëqyrëse.
4. Tarifën për lartësinë e kompensimit e cakton komuna.

Neni 137

Nyjet sanitare higjienike

1. Ndërtesat duhet të kenë nyjet sanitare higjienike. Nëse nuk kanë, pronarët e ndërtesës dhe të lokaleve afariste janë të obliguar që në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje t'i ndërtojnë nyjet sanitare përkatëse higjienike.
2. Ndërtimi i nyjeve sanitare higjienike dhe të gropave septike do të bëhet vetëm nëpër vende të përshatshme. Vendet në të cilat do të ndërtohen duhet të caktohen nga ana e inspektorit dhe organit kompetent për punë komunale.

Neni 138

Pastrimi i gropave septike

Heqja e fekaleve nga gropat septike, nyjet sanitare dhe të ngjashme bëhet me anë të cisternave septike sipas rregullit gjatë natës prej orës 21:00 deri në ora 5:00 të mëngjesit.

Neni 139

Detyrat e kryesve të punëve ndërtimore

1. Kryesit e punëve ndërtimore janë të obliguar që të kujdesen për:
 - 1.1. pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore deri te vendi i shkarkimit të materialit;
 - 1.2. derdhjen e materialit shkapërderdhës dhe gjatë rrënimit të pengohet pluhuri;
 - 1.3. deponimi dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga rrënimi dhe bartjen e tij nga sipërfaqja publike.

Neni 140

Rregullimi i hapsirave pas përdorimit

Personat fizik dhe ata juridik të cilët bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të materialit para ndërtesave në rrugë ose trotuare janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë ato dhe ta pastrojnë vendin.

Neni 141

Pastrimi i borës

1. Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore në pronësi publike, kujdesen personat juridik të cilat i shfrytëzojnë ndërtesat afariste dhe këshillat shtëpiake, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare banesore dhe para hapësirave afariste (punëtoritë, lokalet afariste) kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të hapësirave afariste.
2. Ndërmarrjet dhe qytetarët janë të obliguar që gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga paragrafi 1 të këtij neni ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit ta bart menjëherë jashtë qytetit e më së voni brenda 5 orësh.

3. Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike është e obliguar që nga rrugët, trotualet, trafikut publik dhe atij të dorës së dytë të kujdeset dhe rregullisht t'i pastrojnë ato nga bora dhe akulli si dhe të hedhin kripë mbi to.
4. Ndalohet hedhja e borës dhe akullit në rrugë nga ana qytetarëve dhe ndërmarrjet.

Neni 142

Pastrimi i bores nga qytetaret

Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotualet sipas nevojës do të pastrohen edhe disa herë në ditë duke u angazhuar detyrimisht të gjithë qytetarët dhe ndërmarrjet, në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, e njëjta do të pastrohet në ditën e ardhshme e më së voni deri në ora 9:00 të mëngjesit.

Neni 143

Mbajtja e pastërtisë dhe higjienës komunale në tregje dhe në objektet e tregjeve

Për mbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës komunale nëpër tregje dhe objekte të tregjeve do të kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

Neni 144

Mirëmbajtja e tregjeve

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë tregjet pas kalimit të kohës së punës duhet të pastrohen mirë, lahen dhe të jenë në gjendje të rregullt.

Neni 145

Sigurlmi i ujit ne tregje

Ndërmarrja e cila menaxhon me tregjet, është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të rregullt higjenik të pijshëm për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të njejve sanitare, të cilat duhet rregullisht të pastrohen dhe të mirëmbahen dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve, kontejnerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

Neni 146

Ndalesat

1. Ndalohet:

- 1.1. Pastrimi i tregut dhe i vendeve për shitje gjatë kohës së zgjatjes së afarizmit në treg.
- 1.2. Çdo shitje e mallit dhe e gjërave tjera ushqimore jashtë vendit të caktuar për këtë dhe ekspozimi i tyre para lokaleve afariste.
- 1.3. Shitja dhe ekspozimi i mallrave në vendet dhe hapësirat në afërsinë e tregut, e që do të pengonte qasjen dhe qarkullimin e lirë të blerësve, në hapësirat para tregut dhe në hyrje të drejtpërdrejtë të tregut, të cilat në çdo kohë duhet të jenë të lira për kalimtar blerës dhe trafikun e automjeteve dhe të mjeteve tjera.

Neni 147

Sigurimi i kushteve higjenike në tregun kafëshëve

Në hapësirat e tregut ku bëhet shitja e kafshëve, duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit higjenik për pije dhe ujit për kafshë, si dhe të ndërtohen njeje sanitare me numër të caktuar të kabinave, të

- 1.23. mbajtja e papastërtisë në hapësirën ku bëhet pastrimi i veshmbathjes;
- 1.24. të mbahen mbeturinat dhe fundërrinat nëpër enët të cilat nuk i plotësojnë kushtet për to;
- 1.25. në sipërfaqe publike, rrugë dhe trotuare të bëhet shtrirja e armaturës dhe lidhja për shtylla dhe rendin e drunjve për t'i drejtuar ato;
- 1.26. dalja nga vendi ndërtimor dhe nga sipërfaqet tjera të ngjashme me automjetet të ndotura në sipërfaqe publike të trafikut publik,

Neni 150

Ndalesat në qytet dhe zonat urbane

Në territorin e qytetit dhe në para lagjet ndalohet:

- 1.1. nxjerrja e materialit ndërtimor, eksploatimi i fraksioneve të gurit nga prerjet e tullave skaj rrugëve publike e të ngjashme;
- 1.2. lëshimi ose përcjellja e ujit fekal nga gropat e njejeve sanitare, si dhe mbeturinat e gropave septike nëpër kopshte, kanale, lumenj, në rrugë dhe në oborre fqinje;
- 1.3. të hedhen dhe të derdhen nëpër oborre ose para hapësirave të ndërtesave banesore mbeturinat, fekalet, uji si dhe në çfarëdo mënyre të dëmtohen kushtet higjienike të qytetarëve të tjerë ose të banuesve;
- 1.4. t'u jepet ujë kafshëve nëpër krojet publike;
- 1.5. të hedhen dhe të mbulohen kafshët dhe shpezët e ngordhura jashtë varrezave të destinuara për kafshë;
- 1.6. të largohen dhe të lidhen mjetet tërheqëse në vendet në të cilat nuk janë caktuar për këto qëllime;
- 1.7. të bëhet prodhimi me dorë i tjegullave dhe tullave si dhe i gëlqeres.

Neni 151

1. Në gjithë territorin e Komunës rreptësishtë ndalohet:

djegia e hamullorëve (kashtës dhe mbetjeve të drithërave), gomave, vajrave motorike, plastikës, pesticideve, barnave dhe të gjitha mbeturinave tjera toksike;
hedhja në sipërfaqe të tokës, ujit dhe kanalizimeve e vajrave motorike, pesticideve, barnave dhe substancave tjera toksike;

Neni 152

Kontraktimi i puneve

Për shërbimet të cilat ndërmarrjes i besohen punët për pastrimin e rrugëve të shtruara largimit të borës dhe të akullit, transportimin dhe deponimin e tyre në sipërfaqet në pajtim me këtë rregullore, i takon kompensimi në lartësinë dhe në kushtet të cilat përcaktohen me kontratë dhe me tarifën e lejuar.

Neni 153

Inspektimi

- 1. Inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë ka të drejtë që ta ndalë automjetin i cili transporton mallra, material ndërtimor, material fundërrimor, drunj, thëngjill etj.
- 2. Ndalimin e automjeteve në fjalë inspektori e bënë me paraqitjen e shenjës për komunikacion "Ndalohet trafiku në të dy drejtimet", në të cilin është shkruar "STOP INSPEKTORATI", vozitësit e

automjeteve janë të obliguar që t'i ndalin automjetet në këtë shenjë dhe duhet t'i ofrojnë shënimet që kërkohen nga inspektorët.

3. Ndalimi i automjeteve nga paragrafi 2 e këtij neni nuk guxon të kryhet nëpër vende ku do të bëhet rrezikimi i sigurisë në trafik.

Neni 154 Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e kryejnë organet komunale të administratës si Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektoriatit.

Neni 155 Sanksionet kundërvajtëse

1. Denohet me gjobë në shumën prej 20€ deri 1,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës të personit juridik.
2. Denohet me gjobë në shumën prej 50€ deri 3,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Denohet me gjobë në shumën prej 150€ deri 10,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
 - 4.1 Nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik më së paku dy herë në vit (neni 5 paragrafi 5),
 - 4.2 Nëse nuk ua sigurojnë konsumuesve sasinë e mjaftueshme të ujit higjienik dhe të rregullt (neni 8),
 - 4.3 Nëse nuk e pengon çdo derdhje të tepër të ujit (neni 30),
 - 4.4 Nëse nuk e kryen pastrimin e rregullt të mbledhësve të ujit dhe të pusetave për kanalizimin atmosferik dhe atë fekal, në mënyrë që çdo kohë të mund të përgjigjet destinimit të vet (neni 33),
 - 4.5 Pas kryerjes së punëve të ujësjellësit dhe të kanalizimit të cilat ajo i kryen dhe nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt (neni 34 paragrafi 1),
 - 4.6 Nëse nga rrugët, trotualet dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 35),
 - 4.7 Nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbra jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 46),
 - 4.8 Nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotualet si dhe nëse tereni nuk e bie në gjendjen e mëparshme të rregullt (neni 56),
 - 4.9 Nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 61),
 - 4.10 Nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar të paraparë (nenin 69),
 - 4.11 Nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71,
 - 4.12 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 78 dhe 79,
 - 4.13 Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara me nenin 81,
 - 4.14 Nëse nuk e kryen aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e shpallë me shkrim orarin e punës fillimin dhe mbarimin e punës (neni 84),
 - 4.15 Nëse vërtetohet dhe vlerësohet nga ana e organit kompetent se lëshimi i lejes për rrëmihje dhe evitim të prishjeve nga neni 110 paragrafi 1 nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 110.3),
 - 4.16 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 112,

4.17 Nëse me rastin, kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 paragrafi 1,2,3 dhe 4.

5. Për kundërvajtje nga neni 5 deri 22 dhe neni 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 69, 71, 81, 87, 110, 112, 141, dhe 151 të kësaj rregulloreje do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 50€ edhe personi përgjegjës i personit nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tij.

Neni 156 Sanksionet kundërvajtëse

1. Denohet me gjobë në shumën prej 20€ deri 1,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
2. Denohet me gjobë në shumën prej 50€ deri 3,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Denohet me gjobë në shumën prej 150€ deri 10,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
 - 4.1. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 11 dhe 12;
 - 4.2. për shkak të lidhjes me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa leje (neni 17);
 - 4.3. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 22 dhe 36;
 - 4.4. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 47, 48, 49, 50, 52, 53, 57, 60;
 - 4.5. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 70,72,73,75,76;
 - 4.6. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 80 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 82;
 - 4.7. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 66 paragrafi 1 dhe 2;
 - 4.8. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 86,88 dhe 90;
 - 4.9. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94, 95 paragrafi 1,2,3 dhe 4;
 - 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 96;
 - 4.11. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 119;
 - 4.12. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 111,112,113,114,117;
 - 4.13. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara nga neni 123;
 - 4.14. nëse nuk sillet në pajtim me nenin 124 dhe 125;
 - 4.15. nëse nuk e bënë shpëlarjen e rrugëve dhe pastrimin në pajtim me kontratën në mes të organeve përkatëse të administratës komunale dhe ndërmarrjes punuese kompetente (neni 130,131);
 - 4.16. nëse nuk e siguron numrin e mjaftueshëm të enëve speciale dhe kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave nga të gjitha hapësirat punuese dhe sipërfaqet e lira (neni 134);
 - 4.17. nëse vepron në kundërshtim me nenin 136 dhe 137;
 - 4.18. nëse nuk e bënë pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ndërtimore, nëse nuk e spërkatë materialin e grimtuar gjatë rrënimit në mënyrë që mos të ngjitet pluhuri (neni 139);
 - 4.19. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 139;
 - 4.20. nëse nuk i përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140;
 - 4.21. nëse kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 dhe 142;
 - 4.22. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 143,144,145, 146, 147, 148 dhe 149;
 - 4.23. nëse nuk i respekton nenet 150 dhe 151;
 - 4.24. nëse gjatë qitjes së shenjës së komunikacionit "STOP-INSPEKTORATI" vozitësit e automjeteve të rënda nuk i ndalin dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara inspektorit (neni 153).

5. Për kundërvajtje nga neni 156 të nënparagrafëve 1.11,1.12,1.13,1.14,1.15,1.16,1.17,1.19,1.20, 1.21,1.22,1.23 dhe 1.24 do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 50€ edhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tyre.

Neni 157

Sanksionet kundërvajtëse

1. Denohet me gjobë në shumën prej 20€ deri 1,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik.
2. Denohet me gjobë në shumën prej 50€ deri 3,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual.
3. Denohet me gjobë në shumën prej 150€ deri 10,000€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
 - 4.1. nëse pa lejen përkatëse bënë kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 17),
 - 4.2. nëse bënë ndonjë të veprimeve të ndaluara nga neni 36 paragrafi 1,2,3,4,5,6,7, 8,9 dhe 10,
 - 4.3. nëse bënë ndonjë të veprimeve nga neni 53 paragrafi 1 deri 18,
 - 4.4. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 61,
 - 4.5. nëse vepron në kundërshtim me nenin 62 paragrafi 3, 4 dhe 5,
 - 4.6. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 70 deri 77,
 - 4.7. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 78, 79, dhe 80,
 - 4.8. nëse nuk vepron sipas vendimit të drejtorisë së inspeksionit, respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 81),
 - 4.9. nëse nuk e eviton rrezikun nga rrënim i objekteve i cili është rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, të objekteve fqinjë dhe sigurinë në trafik (neni 82),
 - 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e (neneve 86, 87, 88 dhe 89)
 - 4.11. nëse bënë ndonjë të veprimtarive të ndaluara nga neni 95
 - 4.12. nëse nuk e bënë dezinfektimin e nyjeve sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenin 101;
 - 4.13. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 104;
 - 4.14. nëse nuk u përmbahet masave të caktuara nga nenet 111, 112, 113, 114 dhe 117
 - 4.15. nëse bënë ndonjë të veprimeve me të cilin nuk respektohet neni 126,
 - 4.16. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 141,
 - 4.17. nëse nuk respektohet neni 146,
 - 4.18. nëse bënë ndonjë të veprimeve të ndaluara nga neni 149 nga pika 1 deri në pikën 26.
 - 4.19. nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal në "STOP-INSPEKTORI" vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i afrojnë shënimet e kërkuara nga inspektorit (neni 153).

Neni 158

Sanksionet kundërvajtëse

- 4.6. Nëse nga rrugët, trotuaret dhe sipërfaqet publike nuk e largon materialin e tepërt në afatin e paraparë me vendimin nga ana e organit kompetent (neni 35),
 - 4.7. Nëse i shfrytëzojnë sipërfaqet e gjelbra jashtë suazave të tyre pa lejen e organit kompetent (neni 46),
 - 4.8. Nëse nuk i eviton dëmet në rrugët e trafikut, trotuaret si dhe nëse tereni nuk e bie në gjendjen e mëparshme të rregullt (neni 56),
 - 4.9. Nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 61),
 - 4.10. Nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar të paraparë (nenin 69),
 - 4.11. Nëse nuk vepron në pajtim me nenin 71,
 - 4.12. Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 78 dhe 79,
 - 4.13. Nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara me nenin 81,
 - 4.14. Nëse nuk e kryer aranzhimin profesional të artikujve nëpër vitrina, nuk i shkruan çmimet e artikujve me material të njëjtë, nuk e shpallë me shkrim orarin e punës fillimin dhe mbarimin e punës (neni 84),
 - 4.15 Nëse vërtetohet dhe vlerësohet nga ana e organit kompetent se lëshimi i lejes për rrëmihje dhe evitimin e prishjeve nga neni 110 paragrafi 1 nuk ka qenë i natyrës urgjente (neni 110.3),
 - 5.16 Nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 112,
 - 5.17 Nëse me rastin, kur bie bora nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 141 paragrafi 1,2,3 dhe 4.
6. Për kundërvajtje nga neni 5 deri 22 dhe neni 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 69, 71, 81, 87, 110, 112, 141, dhe 151 të kësaj rregulloreje do të dënohen me të holla (gjobë mandator) në shumën prej 25€ edhe personi përgjegjës i personit juridik nëse deri te kundërvajtja ka ardhur me veprimin apo mosveprimin e tij.

Neni 160

Sanksionet e lehta kundërvajtëse

1. Denohet me gjobë në shumën prej 10€ deri 100€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës te personit juridik,
 2. Denohen me gjobe në shumën prej 30€ deri 250€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
 3. Denohen me gjobë në shumën prej 100€ deri 1.500€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:
- 4.1. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 11 dhe 12;
 - 4.2. për shkak të lidhjes me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa leje (neni 17);
 - 4.3. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 22 dhe 36;
 - 4.4. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 47, 48, 49, 50, 52, 53, 57, 60;
 - 4.5. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga nenet 70,72,73,75,76;
 - 4.6. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 80 paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 82;
 - 4.7. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 66 paragrafi 1 dhe 2;
 - 4.8. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 86,88 dhe 90;
 - 4.9. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94, 95 paragrafi 1,2,3 dhe 4;
 - 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 96;
 - 4.11. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 119;
 - 4.12. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga nenet 111,112,113,114,117;

- 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e (neneve 86, 87, 88 dhe 89)
- 4.11. nëse bënë ndonjë të veprimtarive të ndaluara nga neni 95
- 4.12. nëse nuk e bënë dezinfektimin e nyjeve sanitare dhe gëlqerosjen e tyre të paraparë me nenin 101;
- 4.13. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 104;
- 4.14. nëse nuk u përmbahet masave të caktuara nga nenet 111, 112, 113, 114 dhe 117
- 4.15. nëse bënë ndonjë të veprimeve me të cilin nuk respektohet neni 126,
- 4.16. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 141,
- 4.17. nëse nuk respektohet neni 146,
- 4.18. nëse bënë ndonjë të veprimeve të ndaluara nga neni 149 nga pika 1 deri në pikën 26.
- 4.19. nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal në "STOP-INSPEKTORI" vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara nga inspektori (neni 153).

Neni 162

Sanksionet e lehta kundërvajtjese

1. Denohet me gjobë në shumën prej 10€ deri 100€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik dhe personat përgjegjës të personit juridik,
2. Denohen me gjobe në shumën prej 30€ deri 250€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni personat fizik që ushtrojnë biznes individual,
3. Denohen me gjobë në shumën prej 100€ deri 1.500€ për kundërvajtjen e kryer sipas paragrafit 4 të këtij neni do të ndëshkohen personat juridik .
4. Kundërvajtjet me gjobë si në vijim:

- 4.1. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 35.
- 4.2. nëse i shfrytëzon sipërfaqet publike të gjelbra jashtë destinimeve të tyre themelore pa leje nga organi kompetent (neni 46),
- 4.3. nëse bënë ndonjë të veprimet e ndaluara nga neni 57 paragrafi 1 dhe 2,
- 4.4. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 60,
- 4.5. nëse bënë ndonjë të veprimeve të ndaluara nga neni 70 paragrafi 1 dhe 2
- 4.6. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 78,
- 4.7. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 81 dhe 82,
- 4.8. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 94 dhe neni 95,
- 4.9. nëse nuk e bie terrenin në gjendje të mëparshme të rregullt në sipërfaqen e rrëmihur të paraparë sipas nenit 111,
- 4.10. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 122,123 dhe 126,
- 4.11. nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 129,130 dhe 134,
- 4.12. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 140,
- 4.13. nëse nuk u përmbahet masave të përcaktuara nga neni 146,
- 4.14. nëse bënë ndonjë të veprimeve të ndaluara nga neni 150 pika 1 deri në 7,

Neni 163

Dispozitat ndëshkimore për minorentet

Për kundërvajtjet e caktuara me këtë rregullore, të cilat i bëjnë jo madhorët, të rinjtë, atëherë me gjobë do të dënohen prindërit e tyre, respektivisht kujdestarët.

Neni 164

Xhobot mandatore

Për kundërvajtjet nga nenet: 36, 53, 59, 69, 87, 88, 103, 104, 105, 121, 122, 123, 124, 126, 127, 128, 129, 141, 144, 145, 146, 147, 149, 150, 151 dhe 153, inspektorët komunal kanë autorizime të shqiptojnë dënime (gjoba) mandatore në shumë prej 50 € për persona fizik dhe persona përgjegjës të personit juridik.

II. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

**Neni 165
Zbatimi i rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdesen Drejtorte perkatëse, Ndërmarrjet Publike Komunale dhe Policia.

**Neni 166
Konflikti, ndryshimi dhe plotëslmi i rregullores**

1. Në rast se dispozitat e kësaj rregulloreje bie ndesh me dispozitat e ligjeve të aplikueshme do të vlejnjë dispozitat e atyre ligjeve.
2. Për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje do të zbatohet procedurë e njëjtë me mënyrën siç është miratuar kjo rregullore. Zbatimi praktik i kësaj rregulloreje, mund të rishikohet dhe të iniciohet, ndryshimi dhe plotësimi i saj nëse është e nevojshme, pasi të ketë kaluar afati prej gjashtë (6) muajsh nga dita e miratimit të saj nga ana e Kuvendit të Komunës së _____.

**Neni 167
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditësh pas publikimit ne webfaqen e komunes .

01. nr. _____
Vendl , më _____

Kuvendi I komunës,

Kryesues



